

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit [“B...“] –Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [A.S], kundër të paditurve: Kompania N.T.H [“M...”] me seli në Prishtinë, dhe [N.S], [F.S], [S.S] që të gjithë nga Prishtina, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit [L.T], avokat nga Prishtina, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurve të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Ekonomik, I.EK.nr.421/17, të datës 19.07.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.11.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHEN ankesat e paditësit [“B...“] Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, dhe të paditurve Kompania N.T.H [“M...“] me seli në Prishtinë, dhe [N.S], [F.S], [S.S] që të gjithë nga Prishtina, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.421/17 të datës 19.07.2019 si të **PASAFATSHME**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.421/17 të datës 19.07.2019, në pikën I të dispozitivit është miratuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [“B...“] Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, ashtu që detyrohen të paditurit Kompania N.T.H [“M...“] me seli në Prishtinë, dhe [N.S], [F.S], [S.S], që të gjithë nga Prishtina, që në emër të borxhit nga kontrata e kredisë paditësit t ia paguajnë në mënyrë solidare, shumën prej 20,253.06€, me normë të kamatës siç e aplikojnë bankat afariste të cilat operojnë në Republikën e Kosovës, me rastin e deponimit të mjeteve në afat prej një viti pa destinim të caktuar e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë dt. 13.09.2017, e deri në pagimin definitiv në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Ndërsa në pikën II të dispozitivit është refuzuar pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit [“B...“] Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë e paraqitur kundër të paditurve N.T.H [“M...“] me seli në Prishtinë, dhe [N.S], [F.S], [S.S] që të gjithë nga Prishtina, dhe atë në pjesën ku ka kërkuar që të detyrohen të paditurit që në mënyrë solidare në emër të kamatës për vonesë t’ia paguajnë edhe shumën prej 13,227.96€. Dhe në pikën III të dispozitivit ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë e paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoje ankesën e paditëses si të bazuar, dhe të anulohet aktgjykimi I.EK.nr.421/17 të datës 19.07.2019 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Ekonomike me anë të së cilës ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit [“B...“], Dega në Kosovë.

Kundër këtij aktgjykimi ankese ka paraqitur edhe i autorizuari i të paditurës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozimin që ta prishë

aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me numër I.EK.nr.421/2017, i datës 19.07.2019, i datës 19.07.2019, dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se.

Ankesat janë të pasafatshme.

Gjykata e Apelit me shikimin në fletë kthesën për dorëzim vërtetoi se paditësi aktgjykimin e atakuar I.EK.nr.421/17 të datës 19.07.2019, e ka pranuar me datë 05.08.2019. Ankesa ndaj këtij aktgjykimi është parashtruar në gjykatë me datë 13.08.2019, qka vërtetohet nga data e vendosur në ankesë në vulën e pranimit të gjykatës.

Gjykata e Apelit gjithashtu më shikimin në fletë kthesën për dorëzim vërtetoi se e autorizuar e të paditurëve aktgjykimin e atakuar I.EK.nr.421/17 të datës 19.07.2019, e ka pranuar me datë 05.08.2019, ndërsa ankesa ndaj këtij aktgjykimi është pranuar në gjykatë më datën 13.08.2019, që vërtetohet nga data e vendosur në ankesë në vulën e pranimit të gjykatës.

Pasi që afati për ankesë sipas dispozitës së nenit 509, pika c), të LPK-së, është 7 ditë nga dita e pranimit të aktgjykimit, rezulton se ankesat janë dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor prej 7 ditësh, për faktin se afati fillon të llogaritet nga data 06.08.2019, dhe kur llogariten 7 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesave ka qenë data 12.08.2019. Meqenëse paditësi dhe e paditura aktgjykimin e kanë pranuar me datë 05.08.2019, ndërsa ankesat që të dy palët i kanë paraqitur me datë 13.08.2019, rezulton se ankesat janë paraqitur me vonesë prej 1 dite.

Në bazë të nenit 186.1 të LPK-së, parashihet se ankesa e paraqitur pas afatit të parashikuar me ligj, ankesën jo të plotë, apo ankesën e palejueshme e hedh poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore. Ndërsa në bazë të nenit 186.2 të LPK-së, parashihet se ankesa është e pasafatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor. Pasi që gjykata e shkallës së parë nuk e ka hedh poshtë si të pasafatshme ankesën e paditësit dhe të paditurës, gjykata e shkallës së dytë në bazë të nenit 196 të LPK-së, i ka hedhë poshtë ankesat si të pasafatshme, për shkak se këtë veprim nuk e ka kryer gjykata e shkallës së parë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën a) e lidhur me nenin 196, të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ae.nr.304/2019, me datë 11.11.2019

Kryetari i Kolegjit
Mahir Tutuli d.y.

